



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Raport përmbledhës: Statistikat e Industrisë

Janar, 2025

Përmbledhje e Statistikave të Industrisë

Raporti ofron informata rreth Statistikave Afatshkurtra të Industrisë, duke ofruar një analizë të ecurisë së sektorit të industrisë në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023. Këto statistika janë pjesë e Programit statistikor të ASK-së dhe përpunohen në baza mujore, duke ofruar një pasqyrë të zhvillimit të ciklit ekonomik dhe mundësinë për të bërë parashikime të ardhshme.

Indeksi i qarkullimit në sektorin e industrisë për muajin korrik 2024 tregon një rritje prej 22.68% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2023. Rritja më e madhe është regjistruar në industrinë nxjerrëse (minierat dhe guroret) me 68.14%, ndërsa sektorët e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, industria përpunuese dhe furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbeturinave janë rritur përkatësisht me 23.07%, 21.22% dhe 19.22%.

Indeksi i numrit të punësuarve në sektorin e industrisë shënoi një rritje prej 9.12%, me rritje të konsiderueshme në furnizimin me ujë dhe trajtimin e mbeturinave (22.12%), industrinë nxjerrëse (9.57%), industrinë përpunuese (7.90%) dhe furnizimin me rrymë, gaz dhe ajër të kondicionuar (5.89%).

Indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve gjithashtu tregon një rritje të madhe prej 39.96%. Rritja më e theksuar është regjistruar në furnizimin me ujë dhe trajtimin e mbeturinave (56.29%), pasuar nga industria përpunuese (45.59%), furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (20.76%) dhe industria nxjerrëse (3.20%).

Ky raport pasqyron një rritje të ndjeshme të aktivitetit ekonomik dhe të treguesve të punës dhe pagave në sektorët industrialë të Kosovës gjatë vitit 2024.

Indeksi i Industrisë

Indeksi i qarkullimit në sektorin e Industrisë për muajin Korrik 2024 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Korrik 2023)

Në muajin korrik të vitit 2024, sektorët e industrisë shënuan një rritje prej 22.68% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2023. Sipas aktivitetit ekonomik, rritje të ndjeshme ishin regjistruar në: industrinë nxjerrëse (minierat dhe guroret) me 68.14%; furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 23.07%; industrinë përpunuese me 21.22%; dhe furnizimin me ujë, si dhe veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 19.22%..

Aktivitetet ekonomike sipas NACE Rev-2	Indeksi 2021=100				Ndryshimi në përqindje
	Baza 2021	07.2023	06.2024	07.2024	
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	100,00	91,52	153,60	153,88	68,14%
Industria përpunuese	100,00	127,30	135,80	154,31	21,22%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	100,00	107,28	105,97	132,03	23,07%
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	100,00	108,29	135,32	129,10	19,22%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Indeksi i numrit të punësuarve në sektorin e Industrisë për muajin Korrik 2024 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Korrik 2023)


Në muajin korrik të vitit 2024, sektorët e industrisë shënuan një rritje prej 9.12% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2023. Sipas aktivitetit ekonomik, rritje të ndjeshme janë regjistruar në: furnizimin me ujë dhe veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 22.12%; industrinë nxjerrëse (minierat dhe guroret) me 9.57%; sektorin e industrisë përpunuese me 7.90%; dhe furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 5.89%.

Aktivitetet ekonomike sipas NACE Rev-2	Indeksi 2021=100				Ndryshimi në përqindje
	Baza 2021	07.2023	2024M06	2024M07	
Industria nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	100,00	216,57	276,31	237,30	9,57%
Industria përpunuese	100,00	115,89	124,77	125,04	7,90%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	100,00	92,16	97,81	97,59	5,89%
Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	100,00	104,13	126,41	127,16	22,12%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve në sektorin e Industrisë për muajin Korrik 2024 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Korrik 2023)

Në muajin Korrik të viti 2024 Sektorët e Industrisë kishin rritje 39.96% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Korrik2023). Sipas aktiviteve ekonomike, rritje të ndjeshme ishin regjistruar në: furnizimin me ujë dhe veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 56.29%; industrinë përpunuese me 45.59%; furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 20.76%; si dhe në industrinë nxjerrëse (minierat dhe guroret) me 3.20%.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org